



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 3500/2 Prot.

Tiranë, më 14.07.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1530, datë 24.12.2010.

**SHOQËRISË “O MINING” SH.P.K**  
Njësia Administrative Nr.10, Rr. “Bogdanëve”, Nd.19, Ap.4, Tiranë.

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**  
Blokku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË**  
**MINIERA**

**Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “O MINING” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1530, datë 24.12.2010, për mineralin Hekur-Nikel, në Objektin “Guri i Kuq”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.1929, datë 27.04.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.3500, Prot, datë 28.04.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1530, datë 24.12.2010, për mineralin Hekur-Nikel, në Objektin “Guri i Kuq”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, ku nga kontrolli në objekt u konstatua se nuk ka filluar kryerja e punimeve kapitale të parashikuara në projektin e miratuar në AKBN.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “f” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.1530, datë 24.12.2010, për mineralin Hekur-Nikel, në Objektin “Guri i Kuq”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1530, datë 24.12.2010, për mineralin Hekur-Nikel, në Objektin "Guri i Kuq", Bashkia Pogradec, Qarku Korçë, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**  
**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ILIR BEJTJA**

